



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/08
Datë: 21.04.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 prill 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohen procesverbalet e mbledhjeve 2, 3 dhe 4 dhe transkriptet e mbledhjeve 1, 2, 3 dhe 4 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/08
Datë: 21.04.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe me Ligjin Nr. 05/L-009, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 prill 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës për drejtor në Bordin Drejtues të Ndërmarrjes Publike Qendrore, Telekomit i Kosovës Sh. A. emërohen këta kandidatë:
 - 1.1. Z. Shpëtim Dobra, Kryesues;
 - 1.2. Znj. Sajmie Thaçi, anëtare;
 - 1.3. Znj. Mimoza Vila, anëtare;
 - 1.4. Znj. Florina Jerliu, anëtare;
 - 1.5. Z. Agim Muçaj, anëtar;
 - 1.6. Z. Remzi Ahmeti, anëtar.
2. Të emëruarit nga pika 1. e këtij vendimi kryejnë detyrat dhe përgjegjësitë në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-087 për Ndërmarrje Publike i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-111 dhe me Ligjin Nr. 05/L-009, si dhe me dispozitat tjera ligjore në fuqi.
3. Mandati i të emëruarve nga pika 1. e këtij vendimi zgjatë tre (3) vjet.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/08
Datë: 21.04.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 prill 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/08
Datë: 21.04.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 4. Paragrafi 2 të Ligjit Nr. 04/L-141 për Provimin e Jurisprudencës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 prill 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet propozimi i Ministrisë së Drejtësisë për emërimin e Anëtarëve të Komisionit për Dhënien e Provimit të Jurisprudencës, në këtë përbërje:
 - 1.1. Z. Albert Zogaj, Kryetar i Komisionit, pyetës i lëndës E drejta Civile (materiale dhe procedurale) dhe Zëvendës anëtare Drita Rexhaj;
 - 1.2. Znj. Valbona Disha Haxhosaj, Anëtare e Komisionit, pyetëse e lëndës E drejta Penale dhe Zëvendës anëtar i Komisionit z. Afrim Shala;
 - 1.3. Z. Zenel Leku, Anëtar i komisionit, pyetës i lëndës E drejta Tregtare dhe Zëvendës anëtare Edije Sezairi;
 - 1.4. Znj. Halide Reka, Anëtare e komisionit, pyetëse e lëndës E drejta Kushtetuese, organizimi i sistemit gjyqësor të Kosovës, bazat e sistemit të Bashkimit Evropian dhe të Drejtat e Njeriut dhe zëvendës anëtar z. Hajrip Krasniqi;
 - 1.5. Z. Hajriz Hoti, Anëtar i komisionit, pyetës i lëndës E drejta e Punës dhe E drejta Administrative dhe zëvendës anëtar z. Nenad Lazic.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Komisionin sipas pikës 1. të këtij vendimi t'ia procedojë Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Anëtarëve të Komisionit
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/08
Datë: 21.04.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 paragrafi 2 nënparagrafi 2.1 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 prill 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Grupi Punues ndërministror për bashkërendimin e punëve për zbatimin e marrëveshjes "Për Mobilitetin në Punë" e nënshkruar në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë", me këtë përbërje:
 - 1.1. Përfaqësues nga Ministria e Punëve të Brendshme - Kryesues;
 - 1.2. Përfaqësues nga Zyra e Kryeministrit - anëtar;
 - 1.3. Përfaqësues nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, anëtar;
 - 1.4. Përfaqësues nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, anëtar.
2. Grupi Punues obligohet që brenda 30 ditëve të identifikoj, përpiloj dhe harmonizojë të gjitha aktet, anekset dhe kërkesat që dalin nga marrëveshja në fjalë me qëllim të zbatimit të plotë të kësaj marrëveshjeje.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave;
- Të gjitha ministrive (ministrave);
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së;
- Arkivit të Qeverisë.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/08

Datë: 21.04.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 6 të Ligjit Nr. 05/L-079 për Investime Strategjike në Republikën e Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 prill 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Komisioni Ndërmintor për Investime Strategjike ("Komisioni") për vlerësimin, përzgjedhjen, zbatimin dhe mbikëqyrjen e projekteve për investime strategjike.
2. Komisioni përbëhet nga:
 - 2.1. Rozeta Hajdari, Ministre e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, kryesuese;
 - 2.2. Hekuran Murati, Ministër i Financave, Punës dhe Transfereve, anëtar;
 - 2.3. Liburn Aliu, Ministër i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, anëtar;
 - 2.4. Faton Peci, Ministër i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, anëtar;
 - 2.5. Artane Rizvanolli, Ministre e Ekonomisë, anëtare;
 - 2.6. Elbert Krasniqi, Ministër i Administrimit të Pushtetit Lokal, anëtar;
 - 2.7. Kryetari i komunës në të cilën realizohet investimi strategjik, anëtar;
 - 2.8. Ministri i ministrisë në të cilën realizohet investimi strategjik, anëtar;
 - 2.9. Sami Istrefi, Avokat i Përgjithshëm Shtetëror, anëtar.
3. Sipas fushës, nevojës dhe rrethanave, Komisioni mund të thërras në takim edhe ministri dhe organe tjera shtetërore dhe përfaqësues të grupeve të interesit.
4. Vendimet dhe rekomandimet merren me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të pranishëm të Komisionit, me votim të hapur.
5. Rolin e Sekretarit të Komisionit e kryen Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve, e cila mundëson gjithë mbështetjen e nevojshme për mbarëvajtjen e mbledhjeve të Komisionit.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë
- Agjencisë për Investime dhe përkrahjen e Ndërmarrjeve (KIESA)



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/08
Datë: 21.04.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 24 të Ligjit Nr. 07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, duke u bazuar në nenin 4 paragrafi 2 nënparagrafi 2.1 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 prill 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Plotësohet dhe ndryshohet vendimi Nr. 06/58, i datës 14.01.2021, si në vijim:
 - 1.1. Shfuqizohen të gjitha pikat e këtij vendimi, për të cilat nuk ka pasur ndarje dhe alokime të mjeteve buxhetore, me vendime të veçanta, në përputhje me pikën 2. deri në 5. të vendimit Nr. 06/58, datë 14.01.2021;
2. Ky vendim nuk prek zbatimin e masave për të cilat janë ndarë mjete dhe ka filluar zbatimi i tij, sipas vendimeve të veçanta, në përputhje me pikën 2 deri në 5 të vendimit.
3. Plotësohet dhe ndryshohet vendimi Nr. 01/69, i datës 15.03.2021, si në vijim:
 - 3.1. Pezullohet deri në një vendim tjetër zbatimi i pikave 1-4 të vendimit Nr. 01/69, i datës 15.03.2021, i plotësuar dhe ndryshuar me vendimin Nr. 05/07, i datës 18.04.2021.
4. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve si dhe të gjitha ministritë përgjegjëse si dhe institucionet tjera të prekura nga ky vendim, të sigurojnë zbatim të plotë të këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m


Disa prej masave të përcaktuara në vendimin nr. 06/58, i datës 14.01.2021, nuk janë zbatuar dhe nuk janë ndarë mjete për zbatimin e masave përkatëse. Rrjedhimisht, përmes këtij vendimi shfuqizohen masat e pazbatuara të vendimit nr. 06/58.

Ky vendim nuk prek zbatimin e masave për të cilat janë ndarë mjete dhe për të cilat ka filluar zbatimi sipas vendimeve të veçanta, në përputhje me pikën 2. deri në 5. të vendimit nr. 06/58, të datës 14.01.2021.

Pikat 1. deri në 4. të vendimit nr. 01/69, të datës 15.03.2021, i plotësuar dhe ndryshuar me vendimin nr. 05/07, të datës 18.04.2021, pezullohen përkohësisht, dhe do të trajtohen së bashku me trajtimin e inspektorateve tjera të të dy niveleve, sipas vlerësimit të riskut ndaj ekspozimit në terren për zbatimin e masave kufizuese të Qeverisë së Republikës së Kosovës në menaxhimin e pandemisë, brenda muajit maj 2021.

Qeveria e Republikës së Kosovës me vendime të veçanta do të ndaje mjete për sektorë të caktuar, bazuar në planin përkatës si dhe ndarjet në ligjin vjetor të buxhetit.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave;
- Të gjitha ministrive (ministrave);
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së;
- Arkivit të Qeverisë.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/08
Datë: 21.04.2021


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 24 të Ligji Nr. 07/L-041 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, duke u bazuar në nenin 4 paragrafi 2 nënparagrafi 2.1 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 prill 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet ndarja e mjeteve buxhetore në vlerë prej 6,000,000 € (gjashtë milionë euro), nga Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike me kod 29300, kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere", të cilat ndahen për organizatën buxhetore me kod 213, në nën-programin "Ndërmarrësia" me kod 49400, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere".
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen me qëllim të subvencionimit shoqërive tregtare (bizneseve), përkatësisht për subvencionimin e pagës së punëtorëve dhe/ose subvencionimin e pagesës së qirasë, sipas kushteve të këtij vendimi, si mbështetje të një kategorie të caktuar të bizneseve që kanë pësuar rënie të ndjeshme në të hyra për shkak të kufizimeve të vendosura sipas vendimit Nr. 01/05, të datës 05.04.2021, të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
3. Për subvencionim të pagës së punëtorëve mund të aplikojnë bizneset si vijon:
 - 3.1. Bizneset me aktivitet të vetëm gastronominë;
 - 3.2. Bizneset me nën-sektor gastronominë, vetëm për stafin e angazhuar në gastronomi;
 - 3.3. Bizneset për njësitë që ushtrojnë aktivitetin në qendra tregtare të tipit të mbyllur;
 - 3.4. Bizneset me aktivitet fitneset dhe palestra; dhe
 - 3.5. Bizneset me linja aktive të licencuara për transport ndër-urban të udhëtarëve.
4. Për subvencionim të qirasë mund të aplikojnë bizneset si vijon:
 - 4.1. Bizneset me aktivitet të vetëm gastronominë; dhe
 - 4.2. Bizneset për njësitë që ushtrojnë aktivitetin në qendra tregtare të tipit të mbyllur.
5. Subvencionimi i pagës së punëtorëve bëhet deri në nivelin 50% (pesëdhjetë përqind) të pagës neto të të punësuarve e llogaritur mbi pagën bruto dhe duke qenë i liruar nga tatimi sipas legjislacionit në fuqi, deri në maksimum prej pesëqind (500 €) euro dhe bëhet në llogarinë e të punësuarit. Bizneset e përcaktuara sipas pikës 3 aplikojnë përmes sistemit EDI të ATK-së, duke dorëzuar listën dhe pagat e të punësuarve, sipas deklaratimit në ATK për muajin shkurt 2021. Ndryshimet eventuale që janë bërë pas datës 1 prill 2021 në deklaratën e Tatimit në Paga "WM/CM" për muajin shkurt 2021 nuk merren parasysh në zbatimin e këtij subvencionimi.

6. Përfshihet nga pika 5. e këtij vendimi, të punësuarit që kanë më shumë se një vend pune, përfitojnë vetëm një herë nga kjo masë, ndërsa të punësuarit që kanë vend pune në sektorin publik, përfshirë edhe ndërmarrjet publike, nuk përfitojnë nga kjo masë.
7. Subvencionimi i qirasë bëhet në nivelin deri në 50% të qirasë neto, deri në një maksimum prej 2,500 € (dy mijë e pesëqind euro) për njësi/filialë, për bizneset qiramarrëse duke qenë i liruar nga tatimi sipas legjislacionit në fuqi. Bizneset e përcaktuara sipas pikës 4 aplikojnë përmes sistemit EDI të ATK-së, duke bashkëngjitur kontratën e qirasë, sipas deklaratimit në ATK për muajin shkurt 2021. Ndryshimet eventuale që janë bërë pas datës 1 prill 2021 në deklaratën e Tatimit të mbajtur në burim në Qira "WR" për muajin shkurt 2021 nuk merren parasysh në zbatimin e këtij subvencionimi.
8. Përfshihet nga pika 7. e këtij vendimi, bizneset të cilat kanë qenë pranuese të Masës 14 të Pakos Fiskale Emergjente, të miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me vendimin Nr. 01/19, datë 30.03.2020, dhe nuk u janë përmbajtur kontratave 12-mujore për punëtorët siç ishte kushtëzuar me Masën 14, nuk mund të përfitojnë nga subvencionimi i qirasë sipas këtij vendimi, përveç nëse kontrata 12 mujore është shkëputur sipas fuqisë ligjore në kuptim të nenit 67 të Ligjit Nr. 03/L-212 i Punës.
9. Autorizohet Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve që të themelojë një komision ndërministror për operacionalizimin e këtij vendimi, zërbërthimin e kriterëve dhe zbatimin e kësaj mase.
10. Komisioni ndër-ministror i themeluar sipas pikës 9. të këtij vendimi, ka autorizime që të saktësojë apo zgjerojë kriteret sipas këtij vendimi, dhe të shtrijë fushën dhe natyrën e verifikimeve, sipas nevojës, gjatë vlerësimit të aplikimit të paraqitur për këtë masë. Gjithashtu, ky komision aprovon edhe listën e përfituesve të masave.
11. Komisioni gjatë shqyrtimit të aplikacioneve, për të vlerësuar kushtin themelor, nëse biznesi i tillë ka qenë i ndikuar nga vendimi i Qeverisë sipas pikës 1. të këtij vendimi, merr për bazë kodet "NACE" dhe jo vetëm.
12. Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, përmes strukturave të saj, ose edhe me institucionet tjera sipas nevojës, ruan të drejtën që të verifikojë në çdo kohë informatën e paraqitur, para, gjatë ose pas zbatimit të kësaj mase.
13. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Ekonomisë me strukturat e tyre për zbatimin e këtij vendimi.
14. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave;
- Të gjitha ministrive (ministrave);
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së;
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/08
Datë: 21.04.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 24 të Ligjit Nr. 07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 prill 2021, merr këtë:

V E N D I M


1. Ndahen mjete shtesë financiare për pagesën e shtesave të sektorit shëndetësisë dhe sigurisë, për muajin Prill dhe Maj 2021, në vlerë totale deri në 5,255,565.00 € (pese milionë e dyqind e pesëdhjetë e pesëmijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e pese euro), si në vijim:
 - 1.1. Për sektorin shëndetësor publik në vlerë deri në 4,068,225 € (katër milionë e gjashtëdhjetë e tetëmijë e dyqind e njëzet e pese euro), në kategorinë e shpenzimeve "Paga dhe shtesa", për organizatat buxhetore përkatëse, për pagesën e shtesës mujore për deri në 13802 persona. Shuma e shtesës mujore është në shumë 150 euro bruto për mjekët dhe infermierët dhe 100 euro bruto për stafin mbështetës – teknik, në institucione shëndetësore publike në të tri nivelet e kujdesit shëndetësor, të angazhuar në betejën kundër pandemisë COVID-19. Shtesa në pagë sipas këtij paragrafi paguhet për secilin muaj veç e veç për person sipas listës së përfituesve të aprovuar nga Ministri i Shëndetësisë dhe dorëzuar me shkresë përcjellëse në Thesarin e Kosovës me të gjitha të dhënat tjera të nevojshme për zbatimin e vendimit. Lista e përfituesve sipas këtij paragrafi dorëzohet në Ministrinë e Shëndetësisë nënshkruar nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtarët Kryesor Financiar të organizatave buxhetore përkatëse.
 - 1.2. Për sektorin e sigurisë në vlerë deri në 1,187,340 € (një milion e njëqind e tetëdhjetë e shtatëmijë e treqind e dyzet euro), në kategorinë e shpenzimeve "Paga dhe shtesa", për organizatën buxhetore Ministria e Punëve të Brendshme, nën-programi "Shërbimet administrative" me kod 30000, për pagesën e shtesës mujore në pagë për zyrtarët aktiv policorë për angazhimin e shtuar në terren dhe të ekspozuar drejtpërdrejt në zbatimin e detyrave në menaxhimin e pandemisë COVID-19. Shtesa në pagë sipas këtij paragrafi paguhet për muajt prill dhe maj të vitit 2021 për secilin muaj veç e veç në vlerë 100 € (njëqind euro) bruto për muaj për person sipas listës së përfituesve të dorëzuar nga Policia e Kosovës (Ministria e Punëve të Brendshme) në Thesar, me të gjitha të dhënat tjera të nevojshme për zbatimin e vendimit. Lista e përfituesve sipas këtij paragrafi aprovohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë dhe Ministri i Punëve të Brendshme, dhe dorëzohet me shkresë përcjellëse në Thesarin e Kosovës.

2. Sipas arsyeshmërisë së dhënë nga Ministria e Shëndetësisë, me qëllim të harmonizimit të ndarjeve me shpenzimin real, në vendimin e Qeverisë nr. 08/65 të datës 18.02.2021, të pika 5.1 e vendimit, ndryshon shuma buxhetore nga 100,000 euro në 123,214 euro, kurse të pika 5.2, ndryshon shuma buxhetore 160,000 euro në 220,527 euro.
3. Mjetet për zbatimin e këtij Vendimi ndahen nga nën programi "Programi për Rimëkëmbje Ekonomike (MF)" me kod 29300, nga kategoria e shpenzimeve "Paga dhe shtesa" në vlerë katër milionë e pesëqind e gjashtëmijë e njëqind e gjashtëdhjetë euro (4,506,160 €), nga kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe transferë" në vlerë tetëqind e tridhjetë e tremijë e njëqind e dyzet e gjashtë euro (833,146 €), dhe ndahen tek organizatat buxhetore përgjegjëse për zbatim të këtij vendimi.
4. Autorizohet Ministria e Financave që pas pranimit të listave përfundimtare sipas pikës 1 dhe 2 të këtij vendimi, të bëjë ndarjen buxhetore për të secila OB, në nën programet buxhetore përkatëse në kategorinë e shpenzimeve "Paga dhe shtesa" bazuar në shumën e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi, ndërsa alokimi i mjeteve bëhet çdo muaj, bazuar në çekun e përlllogaritur të pagave së bashku me shtesat përkatëse.
5. Në rast se mjetet e ndara me këtë vendim nuk mjaftojnë për kryerjen e obligimeve sipas kritereve të përcaktuara me këtë vendim, autorizohet Thesari që për pjesën e pambuluar të mundësojë alokimin e parakohshëm nga buxheti aktual i organizatës buxhetore.
6. Pagesa e shtesës mbi pagë realizohet përmes Sistemit të Pagave, në baza mujore, me pagën e muajit përkatës. Në rast se listat përfundimtare sipas këtij vendimi procedohen në Thesar me vonesë, jashtë afatit për procedimin e ndryshimeve në Sistemin e Pagave, të njëjtat shtesa procedohen me pagën vijuese, si pagesë retroaktive e shtesës.
7. Obligohet Zyra e Kryeministrit, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës dhe Komunitatet për zbatimin e këtij vendimi.
8. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Institucionet e lartpërmendura kanë bërë kërkesë në Qeveri për kompensimin financiar lidhur me angazhimin e shtuar në punë dhe ekspozimit ndaj pandemisë COVID-19. Ky propozim-vendim adreson kërkesat minimale të tyre në përputhje me mundësitë buxhetore që ka vendi.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

I u d ë r g o h e t:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/08
Datë: 21.04.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 24 të Ligji Nr. 07/L-041 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 prill 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet ndarja e mjeteve buxhetore në vlerë prej 8,500,000.00 € (tetë milionë e pesëqind mijë euro), tek organizata buxhetore me kod 209, me qëllim mbulimin e kostos së shtesave për skemat sociale dhe pensionale siç janë përcaktuar në pikën 2. të këtij vendimi.
2. Shtesat nga pika 1. e këtij vendimi do të aplikohen si në vijim:
 - 2.1. Pagesë shtesë prej 30% (tridhjetë përqind) mbi shumën mujore për përfituesit nga skema e ndihmës sociale, bazuar në numrin e familjeve përfituese të muajit përkatës dhe anëtarëve të familjes për të gjithë përfituesit e ndihmave sociale, për muajt Prill, Maj dhe Qershor 2021.
 - 2.2. Pagesë shtesë për përfituesit e skemave pensionale që marrin më pak se 100 € (njëqind euro) në muaj. Lartësia e pagesës shtesë do të aplikohet ashtu që pagesa mujore (pensioni bashkë me shtesën) të arrijë shumën 100 € (njëqind euro) në muaj për përfituesit, për muajt Prill, Maj, dhe Qershor 2021.
3. Shpërndarja dhe alokimi i mjeteve buxhetore sipas pikës 2. të këtij vendimi bëhet në kategorinë e shpenzimeve, subvencioneve dhe transfereve dhe në nën-programet me kode organizative si në vijim:
 - 3.1. Shuma prej 2,500,000 € (dy milionë e pesëqind mijë euro) për pagesën shtesë sipas pikës 2.1 të këtij vendimi, në kuadër të nën-programit me kodin organizativ 00500-Ndihmat Sociale.
 - 3.2. Shuma prej 4,380,000.00 € (katër milionë e treqind e tetëdhjetë mijë euro) për pagesën e shtesës sipas pikës 2.2. të këtij vendimi për të gjithë përfituesit e skemës së pensioneve bazike, në kuadër të nën-programit me kodin 00100-Pensionet Bazike.
 - 3.3. Shuma prej 1,497,000.00 € (një milionë e katërqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë euro) për pagesën e shtesës sipas pikës 2.2. të këtij vendimi për të gjithë përfituesit e skemës së pensioneve të aftësisë së kufizuar (PPAK), në kuadër të nën-programit me kodin 00200-Pensionet e Aftësisë së Kufizuar (PPAK).

- 3.4. Shuma prej 120,000.00 € (njëqind e njëzet mijë euro) për pagesën e shtesës sipas pikës 2.2. të këtij vendimi për të gjithë përfituesit e skemës së pensioneve familjare, në kuadër të nën-programit me kodin 02900-Pensionet Familjare.
- 3.5. Shuma prej 3,000.00 (tre mijë euro) për pagesën e shtesës sipas pikës 2.2. të këtij vendimi për të gjithë përfituesit e skemës së pensioneve invalidore të punës, në kuadër të nën-programit me kodin 03000-Pensionet invalidore të punës.
4. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi merren nga nën-programi – Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike, Ministria e Financave me kod buxhetor 29300, kategoria e shpenzimeve subvencione dhe transfere.
5. Shtesa e paraparë në pikën 2. të këtij vendimi realizohet së bashku me pagesën e rregullt të skemave për muajt Prill, Maj dhe Qershor 2021.
6. Alokimi i mjeteve bëhet në baza mujore, në kodin përkatës (00098), bazuar në çekun e pensioneve dhe asistencës sociale, deri në vlerën e kufizuar sipas pikës 2. të këtij vendimi.
7. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve me strukturat e saj për zbatimin e këtij vendimi.
8. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/08
Datë: 21.04.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi (4) dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 14 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, duke u bazuar në nenin 4, paragrafi 2.1 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 prill 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet metoda e pagesës direkte (UN Advance) në formë të avancit tek UNOPS, në emër dhe për Ilogari të Ministrisë së Shëndetësisë si dhe regjistrimi kontabël në SIMFK në kodin përkatës të avancit për pagesa direkte të huamarrjes, në vlerë prej 4,169,016.63 (katër milion e njëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëmbëdhjetë euro e gjashtëdhjetë e tre cent), si pjesë e dytë e avancit të dytë në bazë të kredisë së ratifikuar me Ligjin Nr. 07/L-017 për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim lidhur me Financimin e Projektit Emergjent Covid-19 për Kosovën si dhe bazuar në Marrëveshjen ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë të Republikës së Kosovës (MSH) dhe Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Shërbime të Projekteve (UNOPS).
2. Avanci i regjistruar nga pika 1. e këtij vendimi, të behët në harmoni me Marrëveshjen e nënshkruar midis Ministrisë së Shëndetësisë së Republikës së Kosovës (MSH) dhe Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Shërbime të Projekteve (UNOPS), me numër të referencës 6678-XK, sipas orarit të pagesave faqe nr.18 nen (b) Pagesa e dytë në vlerë prej 4,169,016.63 Euro, e pagueshme jo me vonë se më 31 korrik 2021, dhe me përmbushjen e kërkesave të raportimit në formatin e pranueshëm siç kërkohet në shtojcën III, dhe do të mbyllet përkatësisht arsyetohet nga Ministria e Shëndetësisë ashtu siç pranohen faturat dhe pajisjet e porositura sipas procedurave të blerjes së pajisjeve mjekësore dhe intervenimeve infrastrukturore (renovime), subjekt i kësaj marrëveshje, por jo me vonë se data e përfundimit të Marrëveshjes, 20 dhjetor 2021.
3. Autorizohet dhe obligohet Ministria e Shëndetësisë që të ndërmarrë të gjitha procedurat e nevojshme ligjore për zbatimin e Ligjit Nr. 07/L-017 për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim lidhur me Financimin e Projektit Emergjent Covid-19 për Kosovën, si dhe bazuar në Marrëveshjen ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë së republikës së Kosovës (MSH) dhe Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Shërbime të Projekteve (UNOPS).

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Arsyetim

Duke marrë parasysh që Marrëveshja ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë së republikës së Kosovës (MSH) dhe Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Shërbime të Projekteve (UNOPS) e cila buron nga Ligji Nr.07/1-017 për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim lidhur me Financimin e Projektit Emergjent COVID-19 për Kosovën, parashih prokurimin e pajisjeve mjekësore për parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19, marrë parasysh rregullat e disbursimit dhe prokurimit të Bankës Botërore të cilat janë pjesë e marrëveshjes së ratifikuar që cekin aranzhimet e veçanta të projekteve me agjencitë e UN-it, mundësin e pagesës në avans si dhe në zbatim të nenin 14, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2021, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave;
- Të gjitha ministrive (ministrave);
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës;
- Arkivit të Qeverisë.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 12/08
Datë: 21.04.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 7 paragrafi 5. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 prill 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet propozimi i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit për të kërkuar nga Presidentja e Republikës së Kosovës dhënien e autorizimit Ministres së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit për nënshkrimin e marrëveshjes për financimin dhe drejtimin e zbatimit të projektit Heras +/Arsimi i Lartë, Huluntim dhe Shkencë Aplikative në Kosovë ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe Agjencisë Austriake për Zhvillim – ADA.
2. I rekomandohet Presidentes së Republikës së Kosovës dhënien e autorizimit Ministres së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit për nënshkrimin e marrëveshjes nga pika 1. e këtij vendimi, në përputhje me Ligjin për Marrëveshjet Ndërkombëtare.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë